

KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH

Në Tirane, sot më datë 28.07.2021, ne ambjentet e shoqërisë “**Pentaquark**” sh.p.k. palet u mbledhen për të nënshkruar këto kontrata shit-blerje kuotash me termat e mëposhtme:

Shitësi : z. Nevis Ura, i lindur me datë 06.11.1989 në Shkoder, Shqipëri, banues në adresën : Rr. Vau Dejes, Nd.8, H.1, Bushat, Shkoder, Shqipëri, me shtetësi shqiptare, me zotësi të plote juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet Letërnjoftimit ID Nr. I91106075D e leshuar në datë 09.09.2019, zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë 15.000 (pesëmbëdhjetemije) Leke të kapitalit themelues të shoqërisë “**Pentaquark**” sh.p.k, me NUIS **L61311062D**, me adresë Njesia Administrative Nr.5, Rr.”Haxhi Kika”, Nd.32, H.3, Ap.3, 1022, Tiranë, Shqipëri, me NIPT L61311062D, këtu e më poshtë *Shitësi*.

Blerësi : z. Sokol Dollani, i lindur me datë 17.12.1981 në Gramsh, Shqipëri, banues në adresën : Rr. Muhamet Deliu, Pall. GU-AL 0/1, Shk.2, Kati 5/1, Tirane, Shqipëri, me shtetësi shqiptare, me zotësi të plote juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet Letërnjoftimit ID Nr. 032245214 e leshuar në datë 11.07.2013, këtu e më poshtë *Blerësi*.

Palët e kësaj kontrate :

Në zbatim të nenit 73, 74 dhe 75 e vijues të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, dhe ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të detyrueshme për tregtarët,

biën dakord dhe shprehin vullnetin e tyre për të lidhur këtë kontratë me kushtet dhe termat e mëposhtme:

1. z. **Nevis Ura**, është ortak i shoqërisë Pentaquark sh.p.k. dhe zotëruar i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 15.000 (pesëmbëdhjetemije) Leke.

2. Shitësi, me cilësinë e ortakut të shoqërisë i shet 1 (nje) kuote me pjese te zoterimit te kapitalit te shoqerise 15% Blerësit, me një çmim total prej 15.000 (pesëmbëdhjetemije) Leke.

3. Shitësi dhe Blerësi janë likuiduar për vlerën totale të kuotave të shitura dhe nuk kanë detyrime të pashlyera ndaj njeri-tjetrit.

4. Nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, Shitësi z. **Nevis Ura** humbet pjesen e zoterimit te kapitalit te shoqerise prej 15% dhe e transferon ate tek Blerësi z. **Sokol Dollani**.

5. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë sipas legjislacionit në fuqi nga titulli i pronësisë mbi këte kuote, objekt i kësaj kontrate, që nga data e nënshkrimit të saj, i kalojnë Blerësit. Blerësi bëhet zotërues me të drejta të plota te kësaj kuote të shoqërisë "Pentaquark" sh.p.k.

6. Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

7. Palët zotohen se do të zgjidhin më mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë kontratë, në të kundërt, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

8. Kontrata u hartua në 3 (tre) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike. Një kopje shkon për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit, një kopje e merr blerësi dhe një kopje e merr shitësi.

Palët pasi e lexojnë dhe deklarojnë se e kuptojnë përmbajtjen e saj, e nënshkruajnë kontratën pa vërejtje .

PALET

SHITËSI

Nevis

BLERËSI

